



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-1933/21 datë:20.01.2021



Npi – 01/14 datë: 28.01.2021

Duke u bazuar në nenet 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040; Nenin 9 dhe 12 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Nr.06/L-005; Rregulloren e MAPL Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Kuvendi shqyrtoi edhe kërkesën e Ministrisë të Pushtetit Lokal, Nr.43-911/3 të datës: 14.12.2020 për rishqyrtimin e Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021, Npi-01-267 datë: 24.11.2020, të cilën e prezantoi në Kuvend, Zyrtarja Kryesore Financiare, dhe i rekomandoi Kuvendit anulimin e kësaj rregullore, Kuvendi Aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR ANULIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR TATIMIN NË PRONËN E
PALUAJTSHME PËR VITIN 2021**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2021, e mbajtur më 28.01.2021, unanimisht vendosi të anulojë Rregulloren Komunale për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2021, me numër protokoli Npi-01/267 të datës: 24.11.2020.

II

Kuvendi i Komunës, e ka marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj